



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në Ftesën e datës 27.02.2022 të Komisionit Shtetëror Zgjedhor të Republikës së Sllovenisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 31.03.2022, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Udhëtimit Zyrtar në Republikën e Sllovenisë

- I. Miratohet udhëtimi zyrtar, për pjesëmarrjen e KQZ-së në vëzhgimin e zgjedhjeve për Asamblenë Kombëtare në Republikën e Sllovenisë, që do të mbahen me 24 prill 2022.
- II. Udhëtimi do të realizohet, nga data 22 prill deri më 26 prill 2022.
- III. Pjesëmarrës të udhëtimit zyrtar janë :
 1. Kreshnik Radoniqi, kryesues i KQZ-së
 2. Sami Kurteshi, anëtar i KQZ-së
 3. Arianit Elshani, anëtar i KQZ-së
 4. Rifat Krasniqi, anëtar i KQZ-së
 5. Burim Ahmetaj, Kryeshef Ekzekutiv i SKQZ-së
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 31.03.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 pika (c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03L-040, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 31.03.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Driton Rukiqi**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Fadil Aliu.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Driton Rukiqi, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 23.03.2022, Nr.471/2022, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Fadil Aliu, me rastin e dorëheqjes së tij, për arsye personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati në listën e rirenditur është z.Driton Rukiqi.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit si kandidat i radhës, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021. Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 31.03.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe bazuar në Vendimin e KQZ-së për Miratimin e Planit Dinamik për Ndryshim dhe Plotësim të Rregullave Zgjedhore i datës 22.03.2022, Nr.341/2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 31.03.2022, nxjerr këtë:



VENDIM

Për Miratimin e Punëtorisë së KQZ për Ndryshim/Plotësim të Rregullave Zgjedhore

- I. Miratohet Punëtorja e KQZ-së, për ndryshim/plotësim të Rregullave Zgjedhore.
- II. Punëtorja do të realizohet, nga data 17 prill deri më 21 prill 2022.
- III. Punëtorja si në pikën I të këtij vendimit, do të financohet nga OSBE.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 31.03.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi